



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0934

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, Batisha Ibrahimimi dhe Kimete Gashi - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) Aab Construction Sh.P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë të Komunës së Vushtrrisë në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit Lot1 Rregulimi i memorialeve e fshatarat Beçiq, Dubovc, Galice, Reznik (te qeshmja), Reznik (Famija Ujkani), Pantinë, Studime, Zhilivodë dhe Gllavotin - (Projekt 2 vjecar); Lot 2 Ndërtimi – Rikonstruimi i fushave sportive Samadrexhë, Maxhunaj, Pestovë, Stanocë i Ultë, Pantinë, Shtitaricë dhe Novolan (Projekt 3 vjecare) me numër të prokurimit VU644-24-8039-5-1-1, me 05/12/2024, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si pjesërisht e bazuar ankesa e OE Aab Construction Sh.P.K. me nr. 2024/0934 , e datës 02/10/2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit Lot1 Rregulimi i memorialeve e fshatarat Beçiq, Dubovc, Galice, Reznik (te qeshmja), Reznik (Famija Ujkani), Pantinë, Studime, Zhilivodë dhe Gllavotin - (Projekt 2 vjecar); Lot 2 Ndërtimi – Rikonstruimi i fushave sportive Samadrexhë, Maxhunaj, Pestovë, Stanocë i Ultë, Pantinë, Shtitaricë dhe Novolan (Projekt 3 vjecare) me numër të prokurimit VU644-24-8039-5-1-1,
2. Mbetet në fuqi, Njoftimi mbi vendimin e AK, lidhur me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si në pikën I të dispozitivit.
3. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik Aab Construction Sh.P.K.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 05.08.2024, Aab Construction Sh.P.K në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit.

Ndërsa me datën 13.09.2024 ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me kontratë OE N.N.P. Wenda .

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës pune me vlerë të parashikuar të kontratës 603,797.89€.

Me 18.09.2024, OE Aab Construction Sh.P.K ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Më 23.09.2024 Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 02.10.2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE Aab Construction Sh.P.K me numër protokoll 2024/0934 lidhur me aktivitetin e prokurimit Lot1 Rregulimi i memorialeve e fshatarat Beçiq, Dubovc, Galice, Reznik (te qeshmja), Reznik (Famija Ujkani), Pantinë, Studime, Zhilivodë dhe Gllavotin - (Projekt 2 vjecar); Lot 2 Ndërtimi – Rikonstruimi i fushave sportive Samadrexhë, Maxhunaj, Pestovë, Stanocë i Ultë, Pantinë, Shtitaricë dhe Novolan (Projekt 3 vjecare) me numër të prokurimit VU644-24-8039-5-1-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues Aab Construction Sh.P.K janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi i parë (I) : “Për të punësuarin SH.G-është prezantuar Certifikata sipas kërkesës dhe është në faqen 51-tek PDF-15.Stafi teknik. Në përgjigjen nga ana e AK pas kërkesës për rishqyrtim, është përgjigjur që kjo certifikatë nuk përmbush kërkesën ndërsa më poshtë do të gjeni edhe të bashkangjitur edhe përgjigjen nga lëshuesi i kësaj certifikate ku shumë qartas shihet që kjo Certifikatë është sipas kërkesës. Ku i punësuar SH.G shihet që përmbush shumë qartas kërkesën në pikën f) të dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë.”

Pretendimi i dytë (II) : “Të punësuar A.G nuk kemi mirëpo për A.K-në cilësinë e Elektricitit i cili përmbush kërkesën e) të dosjes së tenderit nuk është kërkuar Certifikate e tillë. Në përgjigjen nga ana e AK pas kërkesës për rishqyrtim, është përgjigjur që nuk është ofruar mirëpo ne ju sqarojmë shumë qartas se kërkesa në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë për pikën e)

është kërkuar një teknik i elektros dhe A.K përmbush kërkesën e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë pasi që nuk është kërkuar për këtë pikë certifikatë për siguri dhe shëndetin në punë.”

Pretendimi i tretë (III) : “Për kërkesën e ngjeshësit i gjeni në pronësi Cilindrin në faqe 23 tek PDF-16.Paisjet. Në përgjigjen nga ana e AK pas kërkeses për rishqyrtim, është përgjigjur që nuk është thënë që fatura nuk është nënshkruar nga ana e blerësit si e tillë nuk mund të konsiderohet si faturë e blerjes, ndërsa kjo faturë është e rregullt, dhe AK ka mundur që të kërkojë sqarim transferin bankar apo dëshmi tjera relevante të cilat e dëshmojnë që paisja është në pronësi të kompanisë sonë, të bashkangjitur me Ankesën e gjeni edhe transferin bankar ku shihet që paisja është në pronësi të kompanisë sonë.”

Pretendimi i katërt (IV) : “Kamioni kiper me vinq i prezantuar nga ana jonë është me peshë bartëse 1490kg dhe si i tillëpesha prej 10kg nuk do të luante ndonjë ndryshim për eliminimin tonë. Ndërsa AK në përgjigjen që ka ofruar pas kërkeses për rishqyrtim është shprehur që ka kërkuar Informata shtesë nga ana e kompanisë që është shpallur fituese për një gjysmë rimorkio i cili e ka tejkaluar peshën e që është mbi 590kg të peshës së kërkuar në Dosjen e tenderit dhe Njoftimit për kontratë (Sqarim i cili nuk është prezantuar gjatë qasjes në dokumente zyrtare) ndërsa për kompaninë tonë shihet qartas që ka shkelur Neni 7 i LPP Barazia në trajtim/jo-Diskriminim i LPP, Neni 59 i LPP Ekzaminimi, Vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve i LPP, Neni 72 i LPP Dokumentacioni dhe informacioni shtese pasi që fare nuk ka kërkuar sqarime.”

Pretendimi i pestë (V) : “Për paisjen Bager-Eskavator pesha 8800kg është prezantuar pronesia e tij si e tillë ju si AK keni mundur të kërkonit sqarim nga ana jonë ose tek kompania e cila është në pronësi ajo paisje e cila është e dokumentuar në DUD dhe në Aneksin7. AK nuk ka kërkuar fare sqarim në lidhje me dokumentin e prezantuar ndërsa ka mundur që të kërkojë informata shtese për këtë pikë përderisa është prezantuar dokumentacioni i një paisjes dhe në listën e paisjeve gjendet.”

Pretendimi i gjashtë (VI) : “Certifikata e prezantuar e punëtorit për gypa, saldim dhe testimin e rrjerit të kanalizimit, kjo certifikatë është e lidhur në bazë të standardit EN 13067:2013. Standard i cili i përfshin kërkesat e juaja. Pavarësisht se ky standard e përmbush kërkesën e parashtruar nga ana e AK, AK për çdo paqartësi që ka pas ka mundur që të kërkojë informata shtesë dhe jo të veproj në mënyrë të kundërligjshme duke na eliminuar në mënyrë të drejtpërdrejt. AK në përgjigjen që ka ofruar për kërkesën për rishqyrtim vazhdimisht është shprehur: “Komisioni i vlerësimit ka mundur të kërkojë sqarime sipas nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së, mirëpo marr për baze se GOE nuk ka qenë i përgjegjshëm edhe në kërkesa tjera të cilat e kanë bërë të pa përgjegjshëm dhe nuk ka kërkuar sqarime, pasi që edhe te ofronte dëshmi shtese për këtë përsëri të shpallej i papërgjegjshëm”, e gjitha kjo që ka shprehur AK nuk qëndron pasi që shihet shumë qartas që në sqarimin që ofruam për eliminimin tonë ne kemi përmbushur kërkesat ndërsa AK ka mundur që për pika të caktuara për të cilat na ka eliminuar neve të kërkojë informata sikurse ka kërkuar informata nga ana e Kompanisë që ka shpallur fituese për pika të cilat është dashur të eliminohet ndërsa ndaj kompanisë sonë nuk ka vepruar po të njëjtën mënyrë e kjo se si ka vepruar AK është

në kundërshtim me Neni 7 i LPP Barazia në trajtim/jo-Diskriminim i LPP-së pasi që në mënyrë direkte ka eliminuar kompaninë tonë dhe ka favorizuar kompaninë tjetër. Kërkesa 3. Stafit teknik, a. - Një (1) punëtorë i certifikuar gypave, saldimit dhe testim rrjeti të kanalizimit dhe ujësjellësit; Dëshmia 3. Lista e stafit teknik duhet të dorëzohet e vulosur dhe nënshkruar nga OE –ik se bashku me certifikatat të cilat duhet të jene origjinal ose kopje. Për pikën a. b. d. dhe e te dëshmohet me certifikata adekuate - origjinal ose kopje.”

Pretendimi i shtatë (VII) : “Për kërkesën Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare 8.1 & 8.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar të vendosura në Njoftim për kontrate (NJK) dhe në Dosje të Tenderit (DT) është kërkuar: Dëshmia e kërkuar dokumentare: Kërkesa 1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjatë tre viteve të fundit fiskale ka qenë prej jo më pak se Lot 1 300,000.00€, kurse per Lot 2 800,000.00€. Në rast të grupit Udhëheqësi duhet të ketë së paku 51% të shumës së kërkuar. Dëshmia 1. Deklaratat e dorëzuara ne Administratën Tatimore të Kosovës apo Kopjet e raporteve financiare dhe raporteve të menaxhimit të certifikuar nga një firmë e njohur e licencuar për kontrollim apo një auditor i licencuar i pavarur. Nuk ekziston asnjë dëshmi se ky OE ka dorëzuar Qarkullimin Financiar sipas kërkesës me rastin e ofertimit. Si dhe gjatë qasjes së dokumenta nuk na është ofruar ndonjë dëshmi se janë kërkuar dëshmi mbi gjendjen ekonomike dhe financiare. Në përgjigjen që ka ofruar AK për këtë pikë pas kërkesës për rishqyrtim ne dyshojmë saj përket këtyre deklaratave të prezantuara pasi që Deklaratat vjetore e vitit 2022, ka mos përputhje me deklaratën vjetore të vitit 2023, pasi që dihet që stoku në fund të vitit bartet në vitin tjetër vijues e në rastin konkret stoku në fund të vitit 2022 që është 6,803.84, është dashur të bartet në stokun fillestar të vitit 2023 ndërsa stoku fillestar në vitin 2023 është deklaruar 14,745.20, ndërsa shihet që këto deklarime nuk janë të rregullta dhe janë paraqitur në mënyrë të gabuara.”

Pretendimi i tetë (VIII) : “Për kërkesën Inxhinier i Ndertimtarise Konstruktiv dhe në cilësinë e Menaxherit të projekt është prezantuar: B.Salihi, Deklarata për percaktimin e menaxherit të kontrates sipas kërkesës në dosjen e tenderit ku shumë qartas është kërkuar që Vendimi me shkrim mbi caktimin e menaxherit të projektit të jetë i vulosur dhe i nënshkruar nga të dyja palët. Mirëpo është nënshkruar dhe vulosur vetëm nga Kompania në fjalë. Gjithashtu në kërkesat në dosjen e tenderit është kërkuar edhe certifikata për menaxher të Kantierit, gjithashtu Certifikatë të cilën nuk e ka prezantuar, krejt qka prezantuar është Certifikata për Siguri dhe Shendet në Pune e lëshuar nga NMA SHPK, Institucion i cili Licencuar për shërbimet si në vijim: AK gjatë përgjigjes të kërkesës për rishqyrtim ka pretenduar se kërkesa jonë është i paqartë, jo i plotë dhe e bën të vështirë të kuptoj se qka kemi dashur të themi, ndërsa pretendimi ynë është shumë i qartas që për këtë inxhinier nuk është prezantuar Certifikata për menaxhimin e kaniterit siq është kërkuar në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë, pasi që ky GOE është munduar përmes certifikatës së sigurisë dhe shëndetit në punë të lëshuar nga NMA SHPK, dhe pozita e cila është cekur në certifikatën e sigurisë që është menaxher i kaniterit të përmbush këtë kërkesë ndërsa NMA nuk është trup certifikuese për lëshimin e certifikatës për menaxhimin e kantierit. Si të tillë e bënë këtë GOE të papërgjegjshëm dhe të eliminuar pasi që nuk ka përmbushur

kërkesën.”

Pretendimi i nëntë (IX): “Për kërkesën Inxhinier i Arkitektures është Prezantuar: E.Jakupi. Për këtë Inxhinier nuk është prezantuar diploma e noterizuar, mirëpo është prezantuar vetëm vendimi i njohjes së Gradës (nostifikimi i diplomës) por jo edhe noterizimi i diplomes sipas kërkesës në DT. AK në përgjigjen që ka ofruar, në kërkesën për rishqyrtim ka pretenduar se për komisionin e vlerësimit ka qenë e mjaftueshme noterizimi i prezantuar i vendimit të njohjes së gradës nga ana e MASHT, ndërsa kërkesa në FTD dhe të njoftimit për kontratë ka qenë shumë e qartë duke e analizuar këtë pretendim nga ana e AK shihet qartas që eliminimi nga ana e AK ka qenë e qëllimshme dhe u munduar të favorizoj këtë OE i cili nuk ka përmbushur kërkesat në Njoftim për kontratë (NJK) dhe në Dosje te Tenderit (DT). Kërkesa në DT/njoftim për kontratë për pretendimin 8 dhe 9: Në dosjen e tenderit/njoftim për kontratë AK ka kërkuar si në vijim: Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2. Kërkesa 2. OE-ik duhet te ofroj dëshmi për stafin profesional si ne vijim: 1.Një inxhinier I diplomuar I ndërtimatisë (drejtimi Konstruktiv) me 5 vite pervoje pune pas diplomit, i trajnuar për mbrojtje dhe siguri në punë si menaxher kantieri. Të jetë menaxher I projektit – projekt menaxher. -Inxhinier apo master Arkitekturës me minimum 5 vite përvojë pune pas diplomimit, Dëshmia 2. Lista e stafit profesional duhet të dorëzohet në origjinal e nënshkruar dhe vulosur nga OE e cila duhet të përmbajë Emrin, Mbiemrin dhe pozicioni në kompani; Vendimi me shkrim mbi caktimin e menaxherit të projektit të jetë i vulosur dhe nënshkruar nga të dyja palët. Për stafin profesional OE të ofroj dëshmi CV- te nënshkruar nga vet Inxh. kopjen e diplomës universitare të noterizuar nga origjinali apo nëse OE i ka të regjistruar në listën e pagave në Administratën Tatimore të Kosovës nuk ka nevojë të noterizohen, kontrata valide kopje ose marrëveshje për angazhim në këtë projekt me punëdhënësin, në kohëzgjatjen e projektit; AK rezervon të drejtën që me rastin e zgjedhjes së fituesit nëse e sheh të nevojshme të kërkojë verifikimin e të gjitha dokumenteve të kërkuara.”

Pretendimi i dhjete (X) : “Për kërkesën a) Nuk ka prezantuar asnje punëtor të certifikuar i gypave, saldimit dhe testi I rrjetit te kanalizimit dhe ujësjellsit sipas kërkesës në DT. Në listen e prezantuar ka prezantuar B.Ahmeti, mirëpo në certifikatën e prezantuar nuk është i certifikuar asnjërin nga këto punë. Duke e parë që nuk është prezantuar certifikata sipas kërkesës në DT ky OE është dashur të eliminohet.AK për përgjigje pas kërkesës për rishqyrtim ka komentuar vetëm se nga cili organ është lëshuar kjo certifikatë për këtë punëtor ndërsa shumë qartas shihet që kjo certifikatë nuk e përmbush kërkesën në Njoftim për kontratë (NJK) dhe në Dosje te Tenderit (DT) pasi që nuk ka asnjërin nga punët që duhet jetë i certifikuar sipas kërkesës për saldimit dhe testim të rrjetit të kanalizimit dhe ujësjellsit.”

Pretendimi i njëmbëdhjete (XI) : “Për kërkesën c) Nuk ka prezantuar asnje mjeshter te kubezave i trajnuar nga siguria dhe shendet ne pune, Në listen e prezantuar ka prezantuar B.Berisha, mirepo ka prezantuar certifikatën i trajnuar për siguri dhe shendet ne pune ne pune nga NMA SHPK mirepo nuk ka prezantuar asnje certifikatë nga Kompanitë të cilat ofrojnë trajnime për mjeshter të kubezave-NMA SHPK si në licensën e prezantuar në vleresimie riskut shkruhet

qartas se për çka është e licensuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Duke e parë që nuk është prezantuar certifikata mbi trajnimet e kryera për mjeshtër të kubëzave sipas kërkesës në Njoftimit për kontratë (NJK) dhe në Dosje te Tenderit (DT)ky OE është dashur të eliminohet. Ndërsa AK në përgjigjen e kërkesës për rishqyrtim ka pretenduar që kjo certifikatë e përmbush kërkesën ndërsa NMA nuk është organ i cili merret me certifikimin e punëtorëve për mjeshtri, dhe për pozitat e punës, pozitën e punës me rastin e aplikimit për kryerjen e vlerësimit të riskut OE e cakton një pozitë ndërsa ky organ merret me certifikimin për siguri dhe shëndet në punë, ndërsa jo për certifikimin për profilet sipas kërkesës.”

Pretendimi i dymbëdhjetë (XII) : “Për kërkesën d) Cerifikata e salduesit me certifikaten EN ISO 9606-1 2013- Në listen e prezantuar ka prezantuar A.Ahmeti- ku certifikata e prezantuar është certifikate pa valditiet. Në cerifikate shkruhet në mënyrë të detajuar, validiteti i saj. Si dhe që certifikata që është valide deri më 27.02.2022. AK ka pretenduar vazhdimisht se nuk është kërkuar me validitet mirëpo ky është një Certifikatë Iso e cila sikurse Isot e tjera duhet të rishikohet nga certifikuesi në mënyrë të jëtë me validitet në mënyrë që të shfrytëzohet. Duke e parë që është prezantuar certifikata jo valide dhe nuk është sipas kërkesës në DT ky OE është dashur të eliminohet, ndërsa shumë qartas në certifikatë është e cekur validiteti dhe procedurat e vazhdimit kjo certifikatë.”

Pretendimi i trembedhjetë (XIII) : “Nuk ka prezantuar elektrikist te trajnuar nga siguria dhe shendeti në pune Në listën e prezantuar ka prezantuar K.Pajaziti, mirëpo ka prezantuar certifikatën i trajnuar për siguri dhe shëndet në punë nga NMA SHPK mirëpo nuk ka prezantuar asnjë certifikatë nga Kompanitë të cilat ofrojnë trajnime për elektrikist. -NMA SHPK si në licensën e prezantuar në vlerësimin e riskut shkruhet qartas se për çka është e licensuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Duke e parë që nuk është prezantuar certifikata mbi trajnimet e kryera për elektrikist sipas kërkesës në DT ky OE është dashur të eliminohet. Ndërsa për këtë pikë nuk kemi pranuar fare përgjigjie nga ana e Autoritetit Kontraktues, ndërsa qartas Autoriteti Kontraktues, nuk ka kthyer asnje përgjigjie për këtë pikë në kërkesën tonë për rishqyrtim ku për këtë pikë Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore të LPP, më konkretisht nenin 108/A, duke mos u përgjigjur dhe arsyetuar përgjigjet në pretendimet tona ankimore, i njëjti ka vepruar edhe në kundërshtim me nenin 59 të LPP, me rastin e ekzaminimit, krahasimit dhe vlerësimit të ofertave. Kërkesa në DT/njoftim për kontratë për pretendimin 10, 11, 12 dhe 13: Në dosjen e tenderit/njoftim për kontratë AK ka kërkuar si në vijim: Për kërkesën Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2. Kërkesa 3. Stafit teknik te vendosura në Njoftim për kontrate (NJK) dhe në Dosje te Tenderit (DT) është kërkuar: a.Një (1) puntore i çertifikuar gypave, saldimit dhe testim rrjeti te kanalizimit dhe ujesjellesit; c.Nje mjeshter i kubezave, i trajnuar nga siguria dhe shendeti në punë. d.Një (1) saldues i çertifikuar me certifikat EN ISO 9606-1 2013. f.Nje (1) elektrikist i trajnuar nga siguria dhe shendeti në punë. Dëshmia 3. Lista e stafit teknik duhet te dorzohet e vulosur dhe nenshkuar nga OE –ik se bashku me certifikatat te cilat duhet te jene origjinal ose kopje. Per piken a. b. d. dhe e te dëshmohet me certifikata adekuate - origjinal ose kopje.”

Pretendimi i katërbëdhjetë (XIV) : “Për kërkesën Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 te vendosura në Njoftim për kontrate (NJK) dhe në Dosje te Tenderit (DT) është kërkuar. Kërkesa 5. Raporti i Vleresimit te Rriskut ne vendin e punes nga nje kompani e licensuar nga MPMS-ja. Dëshmia 5. Kopja e raportit te vleresimit te rriskut e noterizuar. Në dosjen e dorëzuar nga OE i shpallur fitues, Raporti i vleresimit të riskut i dorëzuar nuk përmbush kërkesën pasi që ky raport nuk është dorëzuar sipas kërkesës nuk është i noterizuar, por i noterizuar është vetëm Licensa e Kompanisë që ka kryer vlerësimin. Duke e parë që nuk është përmbushur kërkesa sipas kërkesës në Dosjen e tenderit dhe FTD-së AK është dashur të eliminoj këtë OE dhe jo të shpallet i përgjegjshëm dhe pretendent për nënshkrimin e kontratës.”

Pretendimi i pesëmbëdhjete (XV) : “Për kërkesën Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 te vendosura në Njoftim për kontrate (NJK) dhe në Dosje te Tenderit (DT) është kërkuar: Kërkesa 6. Lista e mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit; Aneksin 7 te DT. Dëshmia 6. OE duhet të plotësoj dhe dorëzoj listën e pajisjeve duke plotësuar Aneksin 7 duke i bashkangjitur librezat valide. Në rast të marrjes me qira duhet të dëshmohet me marrëveshje për këtë projekt me titull dhe numër prokurimi të noterizuar në mes të qiradhënësit dhe qiramarrësit. Aneksi 7-Nuk është plotësuar sipas kërkesës ne DT si dhe nuk janë ofruar të dhënat e pajisjeve sipas kërkesës. Plotësimi i formularit të dosjes së tenderit është kusht administrativ prandaj si e tillë është dashur të Eliminohej ky OE, ku gjithashtu për këtë pretendim tonin nuk kemi pranuar përgjigje në kërkesën tonë për rishqyrtim. Në listën e Mekanizmit dhe Pajisjeve të prezantuar është kërkuar: 1) Se paku një kamion me kran dhe kiper me peshe bartëse min 1.5 ton deri ne max 2.2 ton, ne e kemi të paqartë se si AK ka mundur të verifikojë peshën e ngarkesës si dhe të dhënat e tjera për pajisjen pasi që të dhënat e kësaj pajisjes janë të pa lexueshme në librezën e prezantuar. ku gjithashtu për këtë pretendim tonin nuk kemi pranuar përgjigje në kërkesën tonë për rishqyrtim. Në kërkesën 3)Së pak një gjysmrimori me pashe bartës min 20 ton deri maksim 30 ton. -02-343-XB Gjysmërimorkio i prezantuar nga ana e OE të shpallur fitues është i peshës bartëse 30,520kg. Duke e parë që nuk është përmbushur kërkesa sipas kërkesës në Dosjen e tenderit dhe FTD-së AK është dashur të eliminoj këtë OE dhe jo të shpallet i përgjegjshëm dhe pretendent për nënshkrimin e kontratës. Ndërsa ju si AK na keni eliminuar për pajisjen me diferenc 10kg, ndërsa 520kg nuk qenka problem. Ne ankese gjeni te bashkangjitur përgjigjen e AK. Në njëren përgjigje AK shihet që peshën prej mbi 520kg e ka trajtuar si devijim të vogël dhe nuk ndikon në aspektin përmbajtësor të ekzekutimit të punimeve ndërsa pajisjen e kompanisë sonë nuk është i pranuar për diferencën prej 10kg, si dhe ka pretenduar se ne jemi eliminuar për pikat tjera ndërsa shumë qartas ne edhe më lartë i sqaruam se këtë pika për eliminimin e kompanisë sonë nuk qëndrojnë pasi që ka mundur edhe të kërkojë sqarim konform ligjit ashtu siç ka kërkuar nga kompania Fituese.”

Pretendimi i gjashtëmbëdhjetë (XVI) : “Nga ana e AK nuk është ofruar asnjë dëshmi se janë dorëzuar kërkesat e përshtatshmërisë për këtë procedurë të tenderimit më konkretisht. Dëshmia

2. Në lidhje me Nenin 65, paragrafët 4.1, 4.2 dhe 4.4 të LPP-së, një ekstrakt nga regjistri gjyqësor (Gjykata Komerciale) apo, në mungesë të kësaj, një dokument ekuivalent i lëshuar nga një autoritet kompetent gjyqësor apo administrativ të vendit të themelimit të Operatorit Ekonomik. Ekstrakti Dokumenti nuk duhet të jetë më i vjetër se 6 muaj nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, duhet të dorëzohet nga Operatori Ekonomik të cilit synohet dhënia e kontratës (Original apo kopje e Noteruar). Dëshmia 3. Në lidhje me Nenin 65, paragrafët 3.1, 3.2, 3.3, 3.4, 3.5, 3.6, të LPP-së, një ekstrakt nga regjistri gjyqësor (Gjykata Themelore e vendit të themeluesit të OP. Ek.) apo, në mungesë të kësaj, një dokument ekuivalent i lëshuar nga një autoritet kompetent gjyqësor apo administrativ të vendit të themelimit të Operatorit ekonomik, që vërteton se operatori ekonomik ka të drejtë që të marrë pjesë në një aktivitet të prokurimit dhe se ndaj tij nuk ekziston ndonjë rrethanë e përcaktuar me Nenin 65. Ekstrakti Dokumenti nuk duhet të jetë më i vjetër se 6 muaj nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, duhet të dorëzohet nga Operatori Ekonomik. të cilit synohet dhënia e kontratës, të dorëzohet në Original ose Kopje e Noteruar. Dëshmia 4. Në lidhje me Nenin 65, paragrafi 4.8 i LPP-së, për kontributin e taksave një dëshmi e lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të Operatorit Ekonomik. Dëshmia Dokumenti nuk duhet të jetë më i vjetër se 90 ditë kalendarike nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, duhet të dorëzohet nga OE të cilit synohet dhënia e kontratës (Kopje). Ku mos me ofrimin e këtyre dokumenteve lindin dyshimet se nuk është përmbushur kërkesa për këto dëshmi, këto dyshime janë krejt duke i parë shkeljet që janë bërë duke e shpallur fitues një OE i cili nuk ka përmbushur kërkesat e dosjes së tenderit. Ndërsa për këtë pikë nuk kemi pranuar fare përgjigje nga ana e Autoritetit Kontraktues, ndërsa qartas Autoriteti Kontraktues, nuk ka kthyer asnjë përgjigje për këtë pikë në kërkesën tonë për rishqyrtim ku për këtë pikë Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore të LPP, më konkretisht nenin 108/A, duke mos u përgjigjur dhe arsyetuar përgjigjet në pretendimet tona ankimore, i njëjti ka vepruar edhe në kundërshtim me nenin 59 të LPP, me rastin e ekzaminimit, krahasimit dhe vlerësimit të ofertave. Autoriteti Kontraktues në fund të përgjigjes së kërkesës për rishqyrtim është shprehur se ne jemi të pa përgjegjshëm edhe pasi që kemi dorëzuar deklaratën me shkrim të nënshkruar dhe të vulosur se Punimet kanë një garancion të kualitetit prej 12 muajve, dhe ka pretenduar se kjo e ka dëshmuar se GOE me rastin e përgatitjes së tenderit nuk kane analizuar dosjen e tenderit si dokument themelor për përgatitjen e tenderit pasi që kemi tenderuar në kundërshtim me KVK të kontratës..., (pretendim i cili është ngritur pas kërkesës sonë për rishqyrtim e cila nuk ka qenë fare e cekur në njoftimin mbi vendimin e AK) të bashkangjitur e gjeni edhe përgjigjen e AK, ndërsa ne ju informojmë se ne kemi analizuar në mënyrë shumë të qarte Njoftim për kontrate (NJK) dhe në FTD-në, ndërsa gabimi nuk qëndron tek ne por te Autoriteti Kontraktues, pasi që Aneksin 1 në mënyrë shumë të qartas AK ka kërkuar që të ofrohet një deklaratë e tillë për 12muaj, e mesa duket AK nuk ju është përmbajtur fare Ligjit të prokurimit, pasi që dosjen e tenderit e ka përgatitur, duke kërkuar në Aneksin 1, kualitetin e punimeve prej 12muajve ndërsa KVK ka kërkuar 24 muaj.”

Duke u referuar kërkesave si më sipër OE Aab Construction Sh.P.K konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me neni 1, 2, 6, 7, 10, 52, 59, 60, 69, 72 të LPP-së si dhe neni 1, 40.13, 45.33 të Rrpp-së, Gjithashtu AK ka shkelur edhe dispozitat përkatëse të RrUOPP-

se. Besojmë se i kemi elaboruar me shumë se sa që duhet shkeljet e AK-se ne këtë aktivitet te Prokurimit andaj, duke u bazuar në dëshmitë që u çekën më lartë, kërkojmë nga OSHP që të merr: Vendim të Aprovohet, si e bazuar ankesa e OE "AAB Construction SHPK" Anulohet, vendimi i AK-së dhe lënda kthehet në Rivlerësim, të Detyrohet autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit, ekzaminimit, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni më kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së. Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

Përgjigje e AK në kërkesën për rishqyrtim: "Përgjigje nga AK: Lidhur me këtë pretendim OE ankues ne dhamë sqarim sepse vlerësimi, ekzaminimi dhe krahasim i tenderëve nga kamioni i vlerësimit behet ne pajtim te plote me nenin 59 par. 4 te LPP-se, po citoj: "Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit prandaj kërkesa e përcaktuar ne dosje tenderit dhe Njoftim për kontrate është kërkuar qe punëtorët te jene te certifikuar dhe trajnuar nga siguria dhe shëndeti ne pune, pasi qe GOE ankues nuk kane kërkuar sqarime sipas nenit 53 te LPP-se, para hapjes se tenderit, qe do te thotë se GOE ankues janë pajtuar me këto kriteret e përzgjedhjes ne DT dhe NJK, atëherë marr për baze këto kriteret e përzgjedhjes se kërkesën /dëshminë 3 te FDT-se vërehet qarte se është kërkuar qe punëtorët te jene te "certifikuar dhe trajnuar për siguri dhe shëndet ne pune", kurse punëtori ne fjale ka prezantuar Certifikatën , ku thotë: "për aftësimin e punëtorit për pune te sigurt ne vendin e punës" qe i bie se është i certifikuar për sigurim ne pune, por jo edhe për shëndet ne pune dhe nuk është trajnuar për "Shëndetin ne pune" qe do te thotë se certifikata e prezantuar për këtë punëtorë nuk është ekuivalente me kërkesën e dosjes se tenderit dhe njoftimit për kontrate. Përgjigje nga AK: Lidhur me këtë pretendim OE ankues ne dhamë sqarim sepse vlerësimi, ekzaminimi dhe krahasim i tenderëve nga kamioni i vlerësimit behet ne pajtim te plote me nenin 59 par. 4 te LPP-se, po citoj: "Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit prandaj kërkesa e përcaktuar ne dosje tenderit dhe Njoftim për kontrate është kërkuar qe punëtorët te jene te certifikuar dhe trajnuar nga siguria dhe shëndeti ne pune, pasi qe GOE ankues nuk kane kërkuar sqarime sipas nenit 53 te LPP-se, para hapjes se tenderit, qe do te thotë se GOE ankues janë pajtuar me këto kriteret e përzgjedhjes ne DT dhe NJK, atëherë marr për baze këto kriteret e përzgjedhjes se kërkesën/dëshminë 3 te FDT-se vërehet qarte se është kërkuar pika f. "Një (1) elektrikist i trajnuar nga siguria dhe shëndeti ne pune", andaj punëtori ne fjale A.K. nuk ka ofertuar certifikate siguria dhe shëndeti ne pune, d.m.th. i mungon certifikatë siguria dhe shëndeti ne pune, qe do te thotë se certifikata e prezantuar për këtë punëtorë nuk është ekuivalente me kërkesën e dosjes se tenderit dhe njoftimit për kontrate. Përgjigje nga AK: Lidhur me këtë pretendim OE ankues ne dhamë sqarim sepse vlerësimi, ekzaminimi dhe krahasim i tenderëve nga kamioni i vlerësimit behet ne pajtim te plote me nenin 59 par. 4 te LPP-se, po citoj: "Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në

dosjen e tenderit, prandaj kërkesa e përcaktuar ne dosje tenderit dhe Njoftim për kontrate është kërkuar qe punëtorët të jenë të certifikuar dhe trajnuar nga siguria dhe shëndeti në punë, pasi qe GOE ankues nuk kanë kërkuar sqarime sipas nenit 53 të LPP-se, para hapjes së tenderit, qe do të thotë se GOE ankues janë pajtuar me këto kriteret e përzgjedhjes në DT dhe NJK, atëherë marr për bazë këto kriteret e përzgjedhjes së kërkesës /dëshminë 6 të FDT-se vërehet qarte se është kërkuar tek aneksi 7 nr. 8, ku thotë: se paku një cilindër për ngjeshje, kurse lideri i grupit ka dorëzuar një faturë nga kompania Pleqja Sh.pk., se bashku me DUD doganor, mirëpo Fatura nuk është e nënshkruar nga Bleresi – ABB Constraction SHPK, qe dot e thotë se nuk është faturë e Rregullt, pavarësisht kësaj AK - Komisioni i vlerësimit ka mundur të kërkojë sqarime sipas nenit 59.2 dhe 72 të LPP-se, mirëpo

marr për bazë se GOE nuk ka qenë i përgjegjshëm edhe në kërkesa tjera të cilat e kanë bërë të pa përgjegjshëm dhe nuk ka kërkuar sqarime pasi qe edhe të ofronte dëshmi shtese për këtë pajisje përsëri do të shpallej i papërgjegjshëm. Përgjigje nga AK: Lidhur me këtë pretendim OE ankues në japim sqarimi sepse vlerësimi, ekzaminimi dhe krahasim i tenderëve nga kamioni i vlerësimit bëhet në pajtim të plote me nenin 59 par. 4 të LPP-se, po citoj: “Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përziesishëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit”, prandaj kërkesa e përcaktuar në dosje tenderit dhe Njoftim për kontrate është kërkuar qe punëtorët të jenë të certifikuar dhe trajnuar nga siguria dhe shëndeti në punë, pasi qe GOE ankues nuk kanë kërkuar sqarime sipas nenit 53 të LPP-se, para hapjes së tenderit, qe do të thotë se GOE ankues janë pajtuar me këto kriteret e përzgjedhjes në DT dhe NJK, atëherë marr për bazë këto kriteret e përzgjedhjes së kërkesës /dëshminë 6 të FDT-se vërehet qarte se është kërkuar tek aneksi 7 nr. 1 ku është kërkuar se paku një kamion me kran dhe kiper me peshe bartëse min 1.5 deri në max 2.2 ton, kurse GOE ka dorëzuar kamionët me pehe bartëse 1490 kg me marrëveshje nga kompania Point Constraction ShPK , pavarësisht kësaj AK - Komisioni i vlerësimit ka mundur të kërkojë te përdorë nenin 59 par. Pika (ii) të LPP-se, ashtu siç ka vepruar tek OE i rekomanduar për kontrate lidhur me Gjysmë rimorkion e cila është 590kg mbi max. e lejuar/kërkuar në DT dhe NJK lidhur me transportimin e makinerisë deri në punishte, mirëpo marr për bazë se GOE nuk ka qenë i përgjegjshëm edhe në kërkesa tjera të cilat e kanë bërë të pa përgjegjshëm dhe Komisioni i vlerësimit e ka gjetur këtë mangësi dhe me rastin e hartimit të Raportika mbetur si e gjetur dhe është bartur në letrën standarde të eliminimit për këtë pajisje, mirëpo edhe sikur të pranohet, përsëri do të shpallej i papërgjegjshëm. Përgjigje nga AK: Lidhur me këtë pretendim OE ankues në japim sqarimin sepse vlerësimi, ekzaminimi dhe krahasim i tenderëve nga kamioni i vlerësimit bëhet në pajtim të plote me nenin

59 par. 4 të LPP-se, po citoj: “Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përsiezishëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit”, prandaj kërkesa e përcaktuar në dosje tenderit dhe Njoftim për kontrate është kërkuar qe punëtorët të jenë të certifikuar dhe trajnuar nga siguria dhe shëndeti në punë, pasi qe GOE ankues nuk kanë kërkuar sqarime sipas nenit 53 të LPP-se, para hapjes së tenderit, qe do të thotë se GOE ankues janë pajtuar me këto kriteret e përzgjedhjes në DT dhe NJK, atëherë marr për bazë këto kriteret e përzgjedhjes së

kërkesën /dëshminë 6 te FDT-se vërehet qarte se është kërkuar tek aneksi 7 nr. 5 ku është kërkuar eskavator me peshe min. 9 ton deri ne 17 ton, kurse GOE ka dorëzuar DOD Doganor nga kompania Kushtrim NM ShPK , pavarësisht kësaj AK - Komisioni i vlerësimit ka mundur te kërkoj te përdor nenin 59 par. Pika (ii) te LPP-se, GOE te eliminuar ka dorëzuar DUD doganor ne emër te kompanisë Kushtrimi NM SHPK me te cilën kompani ka marrëveshje për disa pajisje tjera por jo edhe për këtë pajisje, qe do te thotë se nuk është DUD dononor, nuk e plotëson kërkesën e DT dhe NJ, pavarësisht kësaj AK - Komisioni i vlerësimit ka mundur te kërkoj sqarime sipas nenit 59.2 dhe 72 te LPP-së, mirëpo marr për baze se GOE nuk ka qene i përgjegjshëm edhe ne kërkesa tjera te cilat e kane bere te pa përgjegjshëm dhe nuk ka kërkuar sqarime për këtë pajisje, pasi qe edhe te ofronte dëshmi shtese për këtë pajisje përsëri do te shpallej i papërgjegjshëm. Përgjigje nga AK: Lidhur me këtë pretendim OE ankues ne dhamë sqarim sepse vlerësimi, ekzaminimi dhe krahasim i tenderëve nga kamioni i vlerësimit behet ne pajtim te plote me nenin 59 par. 4 te LPP-se, po citoj: “Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgëzohem vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit”, prandaj kërkesa e përcaktuar ne dosje tenderit dhe Njoftim për kontrate, pasi qe GOE ankues nuk kane kërkuar sqarime sipas nenit 53 te LPP-se, para hapjes se tenderit, qe do te thotë se GOE ankues janë pajtuar me këto kriteret e përzgjedhjes ne DT dhe NJK, atëherë marr për baze këto kriteret e përzgjedhjes se kërkesën /dëshminë 3 te FDT-se vrehet qarte se është kërkuar: Kërkesa 3. Stafi teknik a. - Një (1) punëtorë i certifikuar gypave, saldimi dhe testimi rrjeti te kanaizimit dhe ujësjellësit; andaj punëtori ne fjalë A.K. i mungon për gypa, saldim dhe testim te rrjetit te kanalizimit dhe ujësjellësit. Certifikata e prezantuar për punëtorin D.SH. është certifikatë për saldimin e gypave te gazit dhe llojeve te plastikese dhe NUK plotëson “testimin e rrjetit te kanalizimit dhe ujësjellësi, qe do te thotë se certifikata e prezantuar për këtë punëtorë, lidhur me plotësin e kërkesë tek DT dhe NJK, nuk është ekuivalente me kërkesën e dosjeje se tenderit dhe njoftimit për kontrate. Përgjigje nga AK: Lidhur me këtë pretendim OE ankues ne dhamë sqarim sepse vlerësimi, ekzaminimi dhe krahasim i tenderëve nga kamioni i vlerësimit behet ne pajtim te plote me nenin 59 par. 4 te LPP-se, po citoj: “Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit”, prandaj kërkesa e përcaktuar ne dosje tenderit dhe Njoftim për kontrate është kërkuar qe punëtorët te jene te certifikuar dhe trajnuar nga siguria dhe shëndeti ne pune, pasi qe GOE ankues nuk kane kërkuar sqarime sipas nenit 53 te LPP-se, para hapjes se tenderit, qe do te thotë se GOE ankues janë pajtuar me këto kriteret e përzgjedhjes ne DT dhe NJK, atëherë marr për baze këto kriteret e përzgjedhjes tek kapaciteti financiarë te FDT-se vërehet qarte se është kërkuar/Dëshmia: Dëshmia 1. Deklaratat e dorëzuara ne Administratën Tatimore te Kosovës apo Kopjet e raporteve financiare dhe raporteve te menaxhimit te certifikuara nga një firme e njohur e licencuar për kontrollim apo një auditor i licencuar i pavarur., Ndërsa OE i rekomanduar për kontrate e plotëson këtë kërkesë te DT dhe NJK, pasi qe AK ka kërkuar sqarime lidhur me këtë pike, por me rastin e dhënies se dokumenteve gjate kohës sa ishit ne qasje sigurisht pa dashje nuk ju ka ngarkuar këto dëshmi, andaj bashkangjitur me këtë kërkesë gjeni - Deklaratë e dorëzuar ATK për vitet 2023, 2022, dhe 2022 ne vlere total: 1,821,756.14 € për OE te rekomanduar për kontrate i

cili e plotëson kërkesën/dëshminë e dosjes se tenderit dhe njoftimit për kontrate. Përgjigje nga AK: Lidhur me këtë pretendim OE ankues ne dhamë sqarim sepse vlerësimi, ekzaminimi dhe krahasim i tenderëve nga kamioni i vlerësimit behet ne pajtim te plote me nenin 59 par. 4 te LPP-se, po citoj: “Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit”, prandaj kërkesa e përcaktuar ne dosje tenderit dhe Njoftim për kontrate është kërkuar qe punëtorët te jene te certifikuar dhe trajnuar nga siguria dhe shëndeti ne pune, pasi qe GOE ankues nuk kane kërkuar sqarime sipas nenit 53 te LPP-se, para hapjes se tenderit, qe do te thotë se GOE ankues janë pajtuar me këto kriteret e përzgjedhjes ne DT dhe NJK, konkretisht: Dëshmia 2. Lista e stafit profesional duhet të dorëzohet në origjinal e nënshkruar dhe vulosur nga OE e cila duhet të përmbajë Emrin, Mbiemrin dhe pozicioni në kompani; Vendimi me shkrim mbi caktimin e menaxherit të projektit të jetë i vulosur dhe nënshkruar nga të dyja palët. Për stafin profesional OE të ofroj dëshmi CV-te nënshkruar nga vet Inxh. kopjen e diplomës universitare të noterizuar nga origjinali apo nëse OE i ka të regjistruar në listën e pcigave në Administratën Tatimore të Kosovës nuk ka nevojë të noterizohen, kontrata valide kopje ose marrëveshje për angazhim në këtë projekt me punëdhënësin, në kohëzgjatjen e projektit; AK rezervon të drejtën që me rastin e zgjedhjes së fituesit nëse e sheh të nevojshme të kërkojë verifikimin e të gjitha dokumenteve të kërkuara. AK ka konstatuar se OE i rekomanduar për kontrate ka plotësuar ne tërësi këtë kërkesë te dosjes se tenderit dhe NJK, pas i ka dorëzuar te gjitha dëshmitë, vendimin për menaxher kontrate te nënshkruar dhe vulosur certifikate për kantier dhe siguri e shëndetit ne pune, Licencën nga kompania NMA SHPK e cila është e licencuar nga MPMS te gjithë i gjeni bashkangjitur me këtë vendimin mbi kërkesën për rishqyrtim te skenauar dhe për me tepër pretendimi i GOE është i pa qartë, jo i plote dhe e bene te vështire te kuptoje se çka ka dashtë te thotë dhe çka nuk plotëson OE i rekomanduar për kontrate, mirëpo ne kemi verifikuar edhe një here dhe kemi konstatuar se OE te rekomanduar për kontrate i cili ka arrit te plotëson kërkesën/dëshminë 2 tek dosjes se tenderit dhe njoftimit për kontrate.

Përgjigje nga AK: Lidhur me këtë pretendim OE ankues ne dhamë sqarim sepse vlerësimi, ekzaminimi dhe krahasim i tenderëve nga kamioni i vlerësimit behet ne pajtim te plote me nenin 59 par. 4 te LPP-se, po citoj: “Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit”, prandaj duke marr për baze se AK ka rezervuar te drejtën e verifikimit si dhe duke marr për baze se INXH. ne fjale ka dorëzuar vendimin mbi njehjen e gradës (nostifikimine diplomës) te noterizuar qe ky dokument është nxjerr mbi baze e kësaj diplome atëherë kjo nënkupton se ky kriter është plotësuar dhe komisioni i vlerësimit e ka trajtuar ne pajtim me nenin 59 par. 4 pika (ii) te LPP-se qe do te thotë se ky dokument ekziston dhe ka dorëzuar diplomën dhe është pranuar nga komisioni i vlerësimit edhe pse ka mundur te kërkoj sqarime sipas nenit 59.2 dhe 72 te LPP-se, mirëpo e ka marr si te pranueshëm duke plotësuar kërkesën e DT dhe NJK. Përgjigje nga AK: Lidhur me këtë pretendim OE ankues ne dhamë sqarim sepse vlerësimi, ekzaminimi dhe krahasim i tenderëve nga kamioni i vlerësimit behet ne pajtim të plotë me nenin 59 par. 4 te LPP-se, po citoj: “Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në

dosjen e tenderit”, prandaj kërkesa e përcaktuar ne dosje tenderit dhe Njoftim për kontrate është kërkuar qe punëtorët të jenë të certifikuar dhe trajnuar nga siguria dhe shëndeti në punë, pasi qe GOE ankues nuk kanë kërkuar sqarime sipas nenit 53 të LPP-se, para hapjes së tenderit, qe do të thotë se GOE ankues janë pajtuar me këto kriteret e përzgjedhjes në DT dhe NJK,, prandaj OE i rekomanduar për kontrate ka plotësuar këtë kërkesë të dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontrate duke dorëzuar certifikatë për trajnimin nga siguria dhe shëndeti në punë në të cilat shumë çartë shkruan pozita e punës, punëdhënësi, numri i certifikate dhe data e lëshimit, qe dot e thotë se është plotësuar kërkesa e dosjes tenderit dhe njoftimit për kontrate si certifikatë adekuate e cila dëshmon se për cilën pozitë është trajnuar ky punëtor në rastin e certifikimit. Kurse lidhur me certifikatën për z. B.A për testim të rrjetit të kanalizimit dhe ujësjellësit, kjo certifikatë është e lëshuar nga Diakone Training center - DTC e cila është e licencuar dhe specializuar mbi aftësimin profesional e cila është e licencuar për këtë fushë të edukimit dhe certifikimit. Ndërsa lidhur me Mjeshttrin e kubezave z. B.B lidhur me certifikatë e prezantuar nga NMA SHPK e cila siç e sqaruar edhe me lart, duke dorëzuar certifikate për trajnimin nga siguria dhe shëndeti në punë, në të cilat shumë çartë shkruan pozita e punës: Mjeshtër i Kubezave , punëdhënësi, numri i certifikate dhe data e lëshimit, qe dot e thotë se është plotësuar kërkesa e dosjeje tenderit dhe njoftimit për kontrate si certifikate adekuate e cila dëshmon se për cilën pozitë është trajnuar ky punëtor dhe plotëson kërkesën e dosjeje së tenderit dhe njoftimit për kontrate si certifikatë adekuate. Gjithashtu, lidhur me certifikatën për z. A.A. EN ISO 9606-1 2013 ku GOE potencon se nuk është valide, në dosje tenderit nuk është kërkuar të jete valide kjo certifikate sepse kjo certifikate lëshohet për aftësimin e punëtorëve për këtë lloj të punëve dhe aftësohet për ekzekutimin e punëve sipas këtij standardi, andaj kërkesa në dosje tenderit nuk ka qene qe kjo certifikate me qene valide. Gjithashtu ju rikujtojmë GOE ankues se edhe certifikatë e prezantuar nga ana tyre për punëtorin z. B. S, nuk posedon validitet qe dot e thotë se sipas tyre edhe ata vetë e pranojnë se nuk janë të përgjegjshëm me rastin e ngritjes së këtij pretendimi ankimore. Mirëpo po e ri përsëritim se nuk ka qen kërkesë e DT dhe NJK qe kjo certifikatë me qene valide. Përgjigje nga AK: Lidhur me këtë pretendim OE ankues në dhamë sqarim sepse vlerësimi, ekzaminimi dhe krahasim i tenderëve nga kamioni i vlerësimit behet në pajtim të plote me nenin 59 par. 4 të LPP-se, po citoj: “Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit”, prandaj kërkesa e përcaktuar në dosje tenderit dhe Njoftim për kontrate është kërkuar qe punëtorët të jenë të certifikuar dhe trajnuar nga siguria dhe shëndeti në punë, pasi qe GOE ankues nuk kanë kërkuar sqarime sipas nenit 53 të LPP-se, para hapjes së tenderit, qe do të thotë se GOE ankues janë pajtuar me këto kriteret e përzgjedhjes në DT dhe NJK,, Andaj, OE i rekomanduar për kontrate me rastin e vlerësimit të tenderëve për këtë aktivitet të prokurimit nga komisioni i vlerësimit është marr për bazë neni 59.4 par. (ii) i LPP-se, me rastin e pajisjes e gjysemrimorkios me pash bartës min. 20 tone deri në max. 30 ton, pasi qe OE i rekomanduar për kontrate dorëzuar këtë pajisje me peshe bartëse 30.520 kg, duke e trajtuar si devijim i vogël qe nuk ndikon në aspektin përmbajtësorë të ekzekutimit të punimeve, pasi qe kjo pajisje bën vetëm bartjen e makinerisë dhe pajisjeve për ekzekutimin e pajisjeve, ndërsa rasti tek eliminimi juaj ku keni tërhequr parale, lidhur me kamion me kran dhe kiper me peshe bartës 1490 kg ashtu siç kemi sqaruar në pretendimin nr. 4 të këtij vendimi (ju edhe për kundër se keni dorëzuar kamion me kiper dhe në vinc, sikur të mos eliminohen edhe për pika tjera AK sigurisht do të vepronte sipas nenit 59 par. 4 pika (ii) të LPP-së). Bazuar në të gjitha të cekurat si me lart në këtë vendim AK vlerëson se pretendimet e OE ankues janë të pa bazuara, gjithashtu pasi qe kemi analizuar në tërësi edhe pas kërkesë për rishqyrtim nga GOE lidhur me pretendimet e ngritur për këtë aktivitet të prokurimit, kemi konstatuar se GOE është i pa përgjegjshëm pasi qe me rastin e tenderit për këtë aktivitet t

prokurimit ka dorezur DEKLARETN me shkrim te nënshkruar dhe te vulosur nga Lideri i grupit dhe antari i grupit ku theksojnë po citojmë: “Punimet kane një garancion te kualitetit prej 12 muajve” kjo dëshmon se GOE me rastin e përgatitjes se tenderit nuk kane analizuar dosjen e tenderit si dokument themelor për përgatitjen e tenderëve pasi qe kane tenderuar ne KUNDERSHTIM me KVK te kontratës, pasi qe AK tek Përgjegjësia mbi Defektet neni 34.5 ku thotë, po citojmë: Periudha garantuese e defekteve është : Periudha garantuese e defekteve është 2 vite, duke filluar nga data e pranimit teknik të përkohshëm, në shumë prej 10 %o të vlerës së përgjithshme të kontratës, për defektet e paraqitura në objekt. Dokumentit - Policës së Sigurimit të kualitetit të punëve e lëshuar nga një Bankë ose Kompani e Sigurimeve e licencuar nga Banka Qendrore e Kosovës, me afat të validitetit për kohëzgjatjen e periudhës prej 2 vite , duke filluar nga data e pranimit teknik të punëve. Prandaj duke marr për baze se KVK dominojmë mbi KPK atëherë me këtë deklaratë te nënshkruar nga GOE : ABB Construction ShPK. ; Arhico .ing ShPK. është dëshmuar se nuk e kane marr për baze ne tërësi Dosjen e Tenderit si dokument themelor për përdigjen e tenderëve, andaj me këtë veprim dhe me këtë deklaratë te nënshkruar dhe te vulosur nga GOE ankues, është pale pa interes nenin 4 par. 1.26 te LPP-së, sepse KVK nuk negociohen, as nuk sqarohen ato janë te detyrueshëm për OE ne rastin konkret për GOE dhe mos plotësimin apo/ose mos pranimi i KVK automatikisht shpallen si GOE te pa përgjegjshëm administrativisht, qe dot e thotë se për këtë aktivitet te prokurimit janë te pa përgjegjshëm, pasi qe nuk kane tenderuar ne pajtim te plote me Dosjen e tenderit - konkretisht KVK, duke ofruar garancion 1 vjet apo/ose 12 muaj ne kualitetin e punimeve ne kundërshtim me Dosjen e tenderit - KVK. Pasi qe sipas KPK ne nenin 34.5 thotë: 34.5 Periudha e përgjegjesisë se defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjesisë se defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjesisë se defekteve do të fillojë në datën e pranimit të përkohshëm. Andaj kjo deklarate e ofruar nga GOE e benë këtë GOE te pa-përgjegjshëm ne aspektin administrativ dhe pale pa interes sipas nenit 4 par. 1.26 te LPP-së. AK konstaton se duke marr këtë vendim ka pasur parasysh edhe mbrojtjen e parimit “Vlera për paranë”, i cili ne fakt është parim shumë i rëndësishëm për buxhetin e AK dhe te cilin sigurisht AK e ka pasur ne konsideratë, duke vlerësuar, ekzaminuar dhe krahasuar duke respektuar dispozitat ligjore dhe duke marr për baze edhe transparenten dhe trajtimin e barabartë te OE, jo- diskriminimin ne mes te OE duke përfunduar me zbatimin e këtyre dispozitave ligjore ne këtë aktivitet te prokurimit. Bazuar ne te gjitha te cekurat si me lart ne këtë vendim AK vlerëson se pretendimet e OE ankues janë te pa bazuara, te pa sakta dhe ne kundërshtim me dispozitat ligjore te LPP-se. Përfundimisht AK vlerëson se me rasti e marrjes se vendimit si ai i datës 13.09.2024 për te rekomanduar për dhënie te kontratës për OE: NNP “WENDA” - Vushtrri , nuk ka elemente apo prova se janë shkelur dispozitat ligjore te cituara si më lartë ne këtë vendim, me theks te veçantë neni 1 - Qëllimi, neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti, neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi, neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, dhe neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës, sepse është rekomanduar për dhënie te kontratës OE me tenderin e përgjegjshëm dhe me çmimin me te ulët, ndërsa me asnjë prove nuk është vërtetuar se ndonjë OE është trajtuar Jo-barabartë apo diskriminuar, nuk është vërtetuar se nuk ka pasur transparencë apo konkurrencë nga OE lidhur me këtë aktivitet te prokurimit. Nga sa u tha me lartë, e ne pajtim me nenin 62.1 pika d) te Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik, lidhur me pretendimet e OE ne KpR, AK vlerëson se nuk ka asnjë arsye te vendos ndryshe nga ajo qe është thënë si me lartë. Bazuar në dispozitat ligjore te nenit 108/A të LPP-së Autoriteti Kontraktues vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.”

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 14/10/2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë

shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0934/2024, ndërsa me datë 23/10/2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2024/0934 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk është pajtuar lidhur me rekomandimin e raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE është pajtuar lidhur me mendimin e ekspertit .

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE Aab Construction Sh.P.K eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/0934 ka vlerësuar si në vijim:

Konstatimi i parë (I) dhe i dytë (II) : “Pas analizimit të dokumenteve në platformën e prokurimit, Eksperti shqyrtues sqaron si në vijim: Sa i përket kërkesave të stafit teknik AK në dosje të tenderit/njoftim për kontratë ka kërkuar dokumentet si në vijim: Kërkesa 3. Stafit teknik e. Një (1) teknik i elektros, f. Një (1) elektrikist i trajnuar nga siguria dhe shëndeti në punë. Dëshmia 3. Lista e stafit teknik duhet të dorëzohet e vulosur dhe nënshkruar nga OE –ik se bashku me certifikatat të cilat duhet të jene origjinal ose kopje. Për piken a. b. d. dhe e te dëshmohet me certifikata adekuate - origjinal ose kopje. Për kërkesën f). Eksperti shqyrtues konstaton se, GOE ka caktuar në këtë pozitë SH.G. dhe ka dorëzuar certifikatën (Certifikatë për aftësimin e punëtorit për punë të sigurt në vendin e punës) sipas kërkesës së AK-së. Po ashtu për kërkesën e) Një (1) elektrikist i trajnuar nga siguria dhe shëndeti në punë, GOE në këtë pozitë të punësuarin A.K. dhe ka dorëzuar certifikatën – Elektroinstalues.”

Konstatimi i tretë (III) : “Pas analizimit të dokumenteve në platformën e-prokurimit, Eksperti shqyrtues ka vërejtur se, GOE ka dorëzuar faturë të vulosur por e njëjta nuk është e nënshkruar. Eksperti shqyrtues sqaron se, AK në kërkesën në FDT nuk ka kërkuar që të dorëzohet faturë e nënshkruar. Shih në vijim kërkesën e AK-së: Kërkesa 6. Lista e mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit ; Aneksin 7 te DT. Dëshmia 6. OE duhet të plotësoj dhe dorëzoj listën e pajisjeve duke plotësuar Aneksin 7 duke i bashkangjitur libreza valide. Në rast të marrjes me qira duhet të dëshmohet me marrëveshje për

këtë projekt me titull dhe numër prokurimi të noterizuar në mes të qiradhënësit dhe qiramarrësit.”

Konstatimi i katërt (IV) : “Eksperti shqyrtues sqaron se, marr parasysh kërkesën e AK-së në DT/Njofitim për kontratë "Se paku një kamion me kran dhe kiper me peshe bartëse min 1.5 ton deri ne max 2.2 ton", kamioni me vinq i prezantuar më peshë prej 1490 kg nuk plotëson kërkesat minimale të AK-së, por konform nenit 6 të LPP (ekonomiciteti i shfrytëzimi të buxhetit), AK ka të drejtë të konsiderojë ndonjë nga pajisjet e ofruara si "devijime të vogla". Por, gjithmonë duhet të ketë parasysh paragrafin 1 të Nenit 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi të LPP-së: “Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo - diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.”

Konstatimi i pestë (V) : “Për pajisjen “Se paku një bager me peshe min, 7 ton deri max. 9 ton”, Eksperti shqyrtues ka vërejtur se, në ofertën e OE ankues është dorëzuar DUD për pajisjen Bager -Eskavator pesha 8800kg. Në rast se AK- Komisioni i vlerësimit ka pas ndonjë paqartësi lidhur me dokumentet e dorëzuara për pajisjen në fjalë, atëherë në përputhje me nenin 72 dhe nenin 59 të LPP-së, është dashtë të bëjë sqarim të tenderit.”

Konstatimi i gjashtë (VI) : “Për kërkesën a. - Një (1) puntore i certifikuar gypave, saldimi dhe testim rrjeti te kanalizimit dhe ujësjellësit, është ofertuar me punëtorin D.SH. GOE-vë për këtë punëtor ka prezantuar një certifikatë për Saldues, lëshuar nga një Organ certifikues nga Austria. AK – Komisioni i vlerësimit është dashtë të verifikojë certifikatën ose të bëjë sqarim të tenderit në përputhje me nenin 72 dhe nenin 59 të LPP-së.”

Konstatimi i shtatë (VII) : “Në ofertën e OE kanë munguar deklaratat e dorëzuara ne Administratën Tatimore te Kosovës apo Kopjet e raporteve financiare dhe raporteve te menaxhimit te certifikuara nga një firme e njohur e licencuar për kontrollim apo një auditor i licencuar i pavarur, me të cilat dëshmohet qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjatë tre viteve të fundit fiskale ka qenë prej jo më pak se Lot 1 300,000.00€, kurse për Lot 2 800,000.00€. Në rast të grupit Udhëheqësi duhet ti ketë së paku 51% të shumës së kërkuar. Eksperti shqyrtues ka vërejtur se, Deklaratat e dorëzuara ne Administratën Tatimore te Kosovës, të cilat dëshmojnë qarkullimin vjetor të Operatorit Ekonomik janë bashkëngjitë në përgjigjen e kërkesës për rishqyrtim, për të cilat AK ka pohuar se kanë kërkuar sqarim të tenderit. Eksperti shqyrtues sqaron se, në pajtim me paragrafin 10 të Udhëzuesin Nr. 001/2023 për Prokurimin Publik, në përputhje me nenin 72 dhe nenin 59 të LPP-së, AK- Komisionit të vlerësimit i lejohet sqarimi tenderëve gjatë procesit të vlerësimit, por duhet pas parasysh se ky sqarim duhet të bëhet nëpërmjet platformës e-prokurimi në pajtim me Nenin 38.1 të RrPP-së. AK, ti verifikojë Deklaratat vjetore të dorëzuara ne Administratën Tatimore te Kosovës, nëse të njëjtat plotësojnë kërkesën e AK-së dhe se deklaratimet e janë të rregullta.”

Konstatimi i tete (VIII) dhe nëntë (IX) : “Përgjigje në pretendimin 8 dhe 9: Eksperti shqyrtues pas verifikimit të dokumenteve në platformën e-prokurimi ka vërejtur se, OE i rekomanduar për dhënie të kontratës për kërkesën Inxhinier i Ndërtimtarisë Konstruktiv dhe në cilësinë e Menaxherit të projekt ka ofertuar me Inxhinierin B.Salihu dhe për të njëjtin ka dorëzuar

certifikatën për pjesëmarrje në trajnimin nga Siguria dhe Shëndeti në Punë, në pozitën Projekt menaxher, lëshuar nga NMA SH.P.K. AK është dashtë të verifikojë certifikatën nëse e njëjta është sipas kërkesës në FDT. Ndërsa sa i përket kërkesës për Inxhinier apo master Arkitekturës me minimum 5 vite përvojë pune pas diplomimit, OE ka ofertuar me Inxhinierin E.Jakupi dhe për të njëjtin ka dorëzuar Diplomën universitare të Fakultetit të Arkitekturës nga Universiteti “Shën Cirili dhe Metodi” – Shkup. Diploma është e noterizuar sipas kërkesës së AK-së.”

Konstatimi i dhjete (X), njëmbëdhjetë (XI), dymbëdhjetë (XII) dhe trembëdhjete (XIII) : “Pas analizimit të dokumententeve në platformën e - prokurimi, Eksperti shqyrtues sqaron si në vijim:

Për stafin teknik a. Një (1) punëtorë i certifikuar gypave, saldimit dhe testim rrjeti te kanalizimit dhe ujësjellësit, OE i rekomanduar për dhënie të kontratës, ka ofertuar në këtë pozitë me punëtorin B.Ahmeti, për të cilin është prezantuar një certifikatë për pjesëmarrje në trajnimin nga Siguria dhe Shëndeti në Punë por e njëjta nuk është e barasvlershme me kërkesën e AK-së. AK – Komisioni i vlerësimit në përputhje me nenin 72 dhe nenin 59 të LPP-së, mbështetur në listën e stafit të dorëzuar, është dashtë të bëjë sqarimin e tenderëve gjatë procesit të vlerësimit, në mënyrë që të verifikojë nëse B.Ahmeti posedon certifikatë adekuate të gypave, saldimit dhe testimit të rrjetit te kanalizimit dhe ujësjellësit. Për stafin teknik c. Nje mjeshter i kubezave, i trajnuar nga siguria dhe shendetit në punë, OE N.N.P. Wenda – Vushtrri, ka ofertuar në këtë pozitë me punëtorin B.Berisha, për të cilin është prezantuar një certifikatë për pjesëmarrje në trajnimin nga Siguria dhe Shëndeti në Punë. AK për kërkesën c. Një mjeshtër i kubezave, i trajnuar nga siguria dhe shëndeti në punë, si dëshmi dokumentare nuk ka saktësuar që duhet të dorëzohet certifikatë adekuate. Për stafin teknik d. Një (1) saldues i certifikuar me certifikatë EN ISO 9606-1 2013, N.N.P. Wenda, ka prezantuar në këtë pozitë punëtorin A. Ahmeti, por certifikata e dorëzuar nuk ka validitetit. AK – Komisioni i vlerësimit në përputhje me nenin 72 dhe nenin 59 të LPP-së, mbështetur në listën e stafit të dorëzuar, është dashtë të bëjë sqarimin e tenderëve gjatë procesit të vlerësimit, në mënyrë që të verifikojë nëse A. Ahmeti është saldues i certifikuar EN ISO 9606-1 2013 . Ndërsa për stafin teknik f. Një (1) elektrikist i trajnuar nga siguria dhe shëndeti në punë, OE i rekomanduar për dhënie të kontratës ka ofertuar në këtë pozitë me punëtorin K.Pajaziti, për të cilin është prezantuar një certifikatë për pjesëmarrje në trajnimin nga Siguria dhe Shëndeti në Punë. AK për kërkesën f. Një (1) elektrikist i trajnuar nga siguria dhe shëndeti në punë, si dëshmi dokumentare nuk ka saktësuar që duhet të dorëzohet certifikatë adekuate.”

Konstatimi i katërbëdhjetë (XIV) : “Eksperti shqyrtues ka analizuar dokumentet e dorëzuara nga OE i rekomanduar për dhënie të kontratës dhe ka vërejtur se raporti është bërë nga një kompani e licencuar por i njëjti nuk është dorëzuar i noterizuar, ashtu siç është kërkuar nga AK. AK – Komisioni i vlerësimit në përputhje me nenin 72 dhe nenin 59 të LPP-së, është dashtë të bëjë sqarimin e tenderëve dhe të kërkojë nga OE i rekomanduar për dhënie të kontratës të dorëzojë raportin sipas kërkesës së përcaktuar në FDT.”

Konstatimi i pesëmbëdhjetë (XV) : “Sa i përket pretendimit të lartcekur, Eksperti shqyrtues konstaton se, AK duhet të veprojë në pajtim me paragrafin 1 të Nenit 7 Barazia në Trajtim/ Jo-

Diskriminimi të LPP-së: “Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo - diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.”

Konstatimi i gjashtëmbëdhjetë (XVI) : “Eksperti shqyrtues pas analizimit të dokumenteve në platformën e-prokurimi ka vërejtur se, të gjitha dokumentet e lartcekura janë ngarkuar në platformë në ikonën Dokumentet tjera, me datë 12.09.2024. Dokumentet e dorëzuara plotësojnë kërkesën e AK-së. Eksperti shqyrtues i’a rikujton AK-së është obligim ligjor të shqyrtojë kërkesën për rishqyrtim dhe të jap përgjigje në pajtim me paragrafin 9 të Nenit 108/A Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve. Ndërsa sa i përket pretendimit të AK-së, se OE ankues ka ofertuar në kundërshtim me KVK të kontratës sepse nuk ka dorëzuar deklaratën me shkrim të nënshkruar dhe të vulosur se Punimet kanë një garancion të kualitetit prej 12 muajve, Eksperti shqyrtues konstaton se, Autoriteti Kontraktues - Komisioni vlerësues, duhet të veprojë në pajtim me paragrafin 3 të nenit 56 të LPP-së: “..... tenderuesi nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në bazë të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit”. Duke u bazuar në sqarimet e mësipërme, Eksperti shqyrtues rekomandon Panelit shqyrtues se lënda të kthehet në rivlerësim dhe AK– Komuna e Vushtrisë duhet ta bëjë vlerësimin sipas kërkesave të përcaktuara në njoftim për kontratë dhe dosje të tenderit ashtu siç parashihet me Nenin 59 të LPP-së dhe Nenin 40.2 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Është në përgjegjësi, dhe në diskrecion të Autoritetit Kontraktues, respektivisht komisionit të vlerësimit – ZPP, që procesi i vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të bëhet në harmoni të plotë me dispozitat ligjore të LPP-se. Në mënyrë që Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve të bëhet në pajtueshmëri me parimet themelore të përcaktuara me LPP si dhe për të shmangur çfarëdo dileme të mundshme, eksperti shqyrtues rekomandon se AK duhet të veprojë në pajtim me Nenin 72 dhe Nenin 59 të LPP-së të LPP-së dhe të verifikojë dokumentet për të cilat ka paqartësi. Në pajtim me Nenin 38.3 të RrPP-së sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive”. AK gjatë rivlerësimit duhet të ketë parasysh paragrafin 1 të Nenit 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi të LPP-së: “Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo - diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.”

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Bazuar në shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP, duke marrë parasysh faktin që pretendimet e palëve dhe parashtrësat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertës shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor.

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktivitetit të prokurimit, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues mendimet e tij janë pjesërisht të pranueshme dhe se Paneli Shqyrtues me të drejtë e mori në konsideratë pjesërisht Raportin e tij/saj me rastin e vendosjes.

Sa i përket pretendimeve të OE ankues, lidhur me ofertën e OE të rekomanduar për kontratë, paneli shqyrtues, nuk ka vërejtur ndonjë sqarim të plotë dhe në shumicën e përgjigjeve të dhëna për pretendimet ankimore të OE ankues ekspertja shqyrtues deklaroi se AK-ja duhet të kërkojë sqarime bazuar në nenin 59 dhe 72 të LPP-së, pa e elaboruar edhe përgjigjen e autoritetit kontraktues ndaj kërkesës për ri-shqyrtim.

Paneli në këtë rast mori në konsideratë të gjitha pohimet ankimore, aktet dhe veprimet e AK-së dhe raportin e ekspertit shqyrtues me Nr. 2024/0934 të datës 23.10.2024. Paneli shqyrtues, vëren se raporti i ekspertizës nuk mund të merret parasysh në tërësi, duke u bazuar edhe në sqarimet e dhëna nga autoriteti kontraktues i cili me rastin e pranimit të raportit të ekspertizës ka dhënë fakte dhe argumente në përgjigje të raportit të ekspertit.

Me tutje paneli shqyrtues, vlerëson se OE i rekomanduar për kontratë në lidhje me aktivitetin e lartpërmendur ka dorëzuar ofertën e përgjegjshme pasi që edhe në raportin e ekspertizës nuk mohohet ekzistenca e dëshmive në raport me kërkesat e dosjes së tenderit. Për më tepër paneli shqyrtues, vlerëson se kërkesa e ekspertit shqyrtues për sqarime shtese për dokumentet e dorëzuara është e paqarte, i cili në të gjitha pretendimet lidhur me ofertën e të rekomanduarit për kontratë kërkon që të sqarohen.

Paneli shqyrtues, vlerëson se konform nenit 72, ku thuhet: “Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë...”. Në rastin konkret eksperti shqyrtues nuk ka ofruar prova me të cilat do të kontestoheshin dëshmit e dorëzuara nga OE i rekomanduar për kontratë dhe njëherit referuar dispozitës së nenit 72 të cituar më lart, edhe autoriteti kontraktues nuk e ka parë të arsyeshme të kërkojë sqarime lidhur me dëshmit, ekzistenca e të cilave nuk mohohet nga eksperti shqyrtues.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit, përgjigjen e GOE ankues në raportin e ekspertit, përgjigjen e AK në raportin e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e GOE duhet të aprovohet si pjesërisht e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur që Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit – Komuna e Vushtrrisë, të mbetet në fuqi, lidhur me aktivitetin e prokurimit me “**Lot1 Rregulimi i memorialeve e fshatarat Beçiq, Dubovc, Galice, Reznik (te qeshmja), Reznik (Famija Ujkani), Pantinë, Studime, Zhilivodë dhe Gllavotin - (Projekt 2 vjecar); Lot 2 Ndërtimi – Rikonstruimi i fushave sportive Samadrexhë, Maxhunaj, Pestovë, Stanocë i Ultë, Pantinë, Shtitaricë dhe Novolan (Projekt 3 vjecare)**” me numër të prokurimit: VU644-24-8039-5-1-1

Lidhur me pretendimet ankimore të OE ankues kundrejt pretendimeve ankimore lidhur me eliminim të OE ankues konkretisht lidhur me pretendimet 1, 2, 3, 4 dhe 5, pas shqyrtimit të ofertës së OE ankues të eliminuar, eksperti ka konstatuar se i njëjti e plotëson këtë kërkesë të AK. Paneli shqyrtues e konstaton se eksperti shqyrtues e ka pasqyruar gjendjen e fakteve mirë dhe këto të gjetura gjejnë mbështetjen e penalisht shqyrtues, Andaj në këto pika ankimore të OE ankues ka arritur të plotësojë kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë, ashtu siç ka sqaruar edhe AK me rastin e refuzimit të kërkesës për rishqyrtim të 23.09.2024, ku sqaron se AK – Komisioni i vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve ka marrë për bazë nenin 59 par. 4 të LPP-se, ku thotë: “Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm

vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmjja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit në fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve. Andaj këto pika ankimore të OE ankues, Paneli shqyrtues sqaron se janë përmbushur nga tenderuesit pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit, andaj aprovohen si e pjesërisht të bazuar.

Çështja e ngritur dhe ndër më kryesoret është pretendimi ankimor i OE ankues kundrejt pretendimeve ankimore lidhur me eliminimin e OE ankues, konkretisht lidhur me pretendimin ankimor nr. 6 të radhitur sikurse në raportin e ekspertizës, ku ekspertja sqaron se autoriteti kontraktues është dashur të veproj në përputhje me nenin 59 dhe 72 të LPP-se. Paneli shqyrtues e konstaton se eksperti shqyrtues nuk e ka pasqyruar gjendjen e fakteve miredhe këto të gjetura nuk gjejnë mbështetjen e panelit shqyrtues, për faktin se Certifikata e prezantuar nga OE ankues për punëtorin X.Y, ka prezantuar një certifikatë për saldues (lëshuar nga një Organ certifikues nga Austria sipas standardit EN 13067 : 2013), Paneli shqyrtues sqaron se duke ju referuar Agjencisë Kosovare për Standardizim, ky standard specifikon metodën e testimit të njohurive dhe aftësive të një saldatori që kërkohet të kryejë saldime në termoplastikë në ndërtime. Ekzaminimi i aftësive të një salduesi është një kusht thelbësor për sigurimin e cilësisë së punës së saldimit, që do të thotë se ky standard mbulon saldimin e gypave të plastikës (të gjitha llojeve), mirëpo nuk mbulon edhe saldimin e gypave të çelikut, prandaj duke marr për bazë natyrën e këtij aktiviteti të prokurimit i cili ka të bëjë me saldimin e gypave të çelikut, certifikata e prezantuar për punëtorin si saldues nga OE ankues nuk e plotëson kërkesën e dosjes së tenderit. Andaj siç mund të evidentohet nga i gjithë dokumentacioni i këtij aktiviteti të prokurimit, shkresat e lëndës, pretendimet e ngritura, ofertuesit ankues nuk kanë arritur të dëshmojnë me fakte dhe prova konkrete se kanë ofertuar në përputhje me të gjitha kërkesat teknike të kërkuara në DT dhe NJK. Prandaj paneli shqyrtues ka vendosur të pranojë dhe të respektojë këtë vendim të AK-së për këto LOT-e. Ky vendim është nxjerrë nga një komision i vlerësimit brenda AK-së, i cili supozohet të jetë profesional dhe të ketë përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës, bazuar në nenin 59 paragrafi 1 të Ligjit për Prokurim Publik (LPP). Rrjedhimisht, pretendimet e ankues për këtë pike kualifikohet si i pa-bazuar.

Lidhur me pretendimet ankimore të OE ankues kundrejt OE të rekomanduar për kontratë konkretisht lidhur me pretendimin 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, dhe 15 ekspertja sqaron se autoriteti kontraktues është dashur të veproj në përputhje me nenin 59 dhe 72 të LPP-se si AK ta marr për bazë nenin 7 të LPP-së. Paneli shqyrtues e konstaton se eksperti shqyrtues nuk e ka pasqyruar gjendjen e fakteve miredhe këto të gjetura nuk gjejnë mbështetjen pjesërisht nga ana e panelit shqyrtues. Prandaj OEi rekomanduar ka arritur të plotësojë kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë, ashtu siç ka sqaruar edhe AK me rastin e refuzimit të kërkesë për rishqyrtim të 23.09.2024, ku sqaron se AK – Komisioni i vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve ka marr për bazë nenin 59 par. 4 të LPP-se, ku thotë: “Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmjja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit në fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të

shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve. Andaj këto pika ankimore të OE ankues, Paneli shqyrtues sqaron se janë përmbushur nga tenderuesit pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit, andaj aprovohen si e pjesërisht të bazuar.

Nisur nga shpjegimet si më sipër, Paneli konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në harmoni me dispozitat e cituara si më sipër konkretisht nën 59 dhe 60 të LPP dhe ka zbatuar drejtë dosjen e tenderit sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 27, sipas të cilit, autoriteti kontraktues përpilon dosjen e tenderit me të gjitha informatat përkatëse përfshirë të gjitha termet dhe kushtet materiale të saj, procedurat e zbatueshme të prokurimit, çfarëdo kërkesë të aplikueshme të përshtatshmërisë ose ndonjë kriter të përzgjedhjes, procedurat e ankesës si dhe informatat e tjera përkatëse siç kërkohen nga ky ligj ose siç i sheh të domosdoshme autoriteti kontraktues. Në kuptim të kësaj dispozite, dosja e tenderit përbën dokumentin kryesor të prokurimit dhe se publikimi i sajë supozohet të jetë në harmoni të plotë me qëllimet e LPP-së, të siguroj mënyrën efikase të shfrytëzimit të fondeve publike, të promovoj integritetin e vet procesit të prokurimit dhe të kulturës institucionale dhe të profesionalizuar.

Andaj, paneli shqyrtues në përputhje me Ligjin për Prokurim Publik (LPP) dhe parimet themelore të tij, Autoriteti Kontraktues (AK) ka për detyrë të sigurojë që procesi i prokurimit të jetë efikas, transparent dhe i drejtë, duke trajtuar të gjithë operatorët ekonomikë në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese. Kjo përfshin edhe detyrimin për të garantuar përdorimin ekonomik dhe efektiv të fondeve publike, duke mos kontribuar dhe prolonguar këtë aktivitet të prokurimit. Përfundimisht, bazuar në sqarimet e mësipërme, rezulton për këtë panel se AK, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve është bërë në pajtim të plotë me dispozitat ligjore të nenit 59 të LPP-së dhe njëkohësisht është respektuar edhe nën 60 i LPP-së si kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm më çmimin më të ultë. Po ashtu, Paneli shqyrtues detyrohet ta marrë në konsideratë faktin parimore se duhet ti ketë parasysh edhe dispozitat e nenëve 1, 6 dhe 7 të LPP-së përmbajtja e të cilave përbën fakt notor për të gjitha AK dhe OE.

Paneli Shqyrtues gjatë krahasimit dhe ekzaminimit të dokumentacionit, ka marrë parasysh edhe nën 104 par. 4 të LPP ku përcaktohet se *“Në ndërmarrjen e masave të përcaktuara OSHP duhet të veprojnë në mënyrë proporcionale me shkeljen e pretenduar ose çështjen për të cilën është paraqitur ankesa, dhe të marrë për bazë pasojat e mundshme të veprimeve ose masave në të gjitha interesat që mund të dëmtohen, duke përfshirë interesin publik”*. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues është nisur nga parimi themelor për mbrojtjen e interesit të publikut në aspektin e parandalimit të vonësive të paarsyeshme në këtë aktivitet të prokurimit.

Paneli Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nën 103, nën 105 dhe nën 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Paneli Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I dhe II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 5 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimin të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E VUSHTRRIË**
- **OE - AAB CONSTRUCTION SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: